



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 10124 Prot

Tiranë, më 11 / 09 / 2023

NJOFTIM

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit nr. 90 dt.27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Vendimit nr 326, datë 31.05.2023 “Pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”; Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”; Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së; shpall 1 (një) vend vakant në pozicionin e punës:

Teknik i Mesëm i Specialiteteve të Ndryshme (kondicionerist/e) pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik;

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

- Të ketë arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional dhe të jetë i certifikuar në përdorimin e pajisjeve kondicionerike;
- Të ketë përvojë pune mbi 10 vjet në këtë fushë;
- Të ketë njohuri të mira të përdorimit dhe mirëmbajtjes së xhillerave të të gjithë mekanizmit të kondicionimit qendror në institucion;

- mirëmbajtje kondicionerët e ambienteve dhe të ndezë kondicionerët në çdo orë të punës së punonjësve të TKOBAP;
- Të konstatojë çdo defekt në sistemin e kondicionimit dhe të vërë në dijeni eprorin lidhur me të.
 - Të zbatojë rregullat e etikës në komunikimin me punonjësit e tjerë të TKOBAP (me eprorët dhe kolegët e tij) dhe të jetë i aftë të punojë në grup;
 - Të kryejë punën që i ngarkohet duke zbatuar me përpikmëri rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi CV;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara;
5. Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka);
6. Fotokopje të librezës së punës;
7. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore;
8. Një numër telefoni si dhe adresa e plotë të vendbanimit.

*Dokumentat duhen të paraqiten në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në e-mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 16/10 2023. Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet numrit të tyre të kontaktit ose me e-mail nga Sekretaria e Institucionit për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA

